



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 01.10.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
I PROJEKTLIGJIT “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR
BASHKËPUNIM TEKNIK 2018 PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJE PËR
NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIM TË SHQIPËRISË NË BE NË SEKTORIN
EKONOMIK”

- **Hyrje**

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **01.10.2019**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “*Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”*”.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Financave dhe Ekonomisëw përfaqësuar nga Znj. Belinda Ikonimi., Zevendesministre.

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave i propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisëw, në mbështetje të neneve 78 , 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës,

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 78 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- **Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit**

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “*Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”*”.

Kjo marrëveshje është propozuar nga pala gjermane, nisur nga dëshira për t’i forcuar e thelluar marrëdhëniet ekzistuese miqësore midis dy vendeve nëpërmjet bashkëpunimit teknik, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik të Republikë së Shqipërisë,

duke iu referuar angazhimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë në Protokollin e bisedimeve qeveritare të datës 22.10.2018.

Objektivi kryesor i këtij projekti është forcimi i kompetencave për zhvillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE, me fokus në disa kapituj të caktuar të legjislacionit të BE-së, që i përkasin sektorit ekonomik. Për arritjen e këtij objekti, pritet që projekti të japë rezultate në tri fusha komplementare veprimi:

- *Zhvillimi i kapaciteteve dhe i metodologjive: në këtë fushë projekti pritet të japë mbështetje për pajisjen e anëtarëve të grupeve ndërinstitucionale të punës për disa kapituj të caktuar me instrumente pune, si edhe njohuri e aftësi të nevojshme për zhvillimin e negociatave.*
- *Parapërgatitje për të adresuar kushtet potenciale për hapjen/mbylljen e negociatave në kapitujt e caktuar (opening/closing benchmarks): në këtë fushë pritet të jepet mbështetje për përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe të planeve të veprimit, të shoqëruara me masa për zhvillimin e kapaciteteve personale në hartimin e tyre.*
- *Përfshirja e shoqërisë civile: në këtë fushë pritet të jepet mbështetje për identifikimin e aktorëve relevantë të shoqërisë civile, sipas fushave të caktuara dhe përfshirja efektive e tyre në përgatitjet për bisedimet e anëtarësimit.*

Për zbatimin e këtij projekti, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht **kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej 2 000 000,00 (dy milionë) eurosh.** Projekti do të ketë një kohëzgjatje prej 3 vjetësh.

Për zbatimin e këtij projekti pala gjermane ka ngarkuar Shoqërinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ GmbH).

Mbështetja dhe zbatimi i këtij projekti është me shumë interes për vendin tonë në kuadrin e zhvillimit të negociatave për anëtarësim. Ky bashkëpunim do të ofrojë një kontribut të rëndësishëm në kuadër të procesit të *screening* dhe përgatitjes për zhvillimin e bisedimeve për anëtarësim në disa kapituj të caktuar që janë tejet të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, kjo marrëveshje paraqet interes në aspektin e zhvillimit social dhe ekonomik të Republikës së Shqipërisë.

Në marrëveshje përcaktohet se angazhimet e marra në kuadër të këtij projekti dhe, referuar shumës prej 2.000.000 eurosh, do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda katër viteve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit dhe eventualisht të financimit (Neni 1, pika 5 e Marrëveshjes). Detajet e projektit si dhe detyrimet dhe shërbimet që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, që do të lidhen ndërmjet institucioneve që janë ngarkuar ose do të ngarkohen me zbatimin e projektit (Neni 2 i Marrëveshjes).

Në marrëveshje janë parashikuar gjithashtu detyrimet e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në kuadër të zbatimit të këtij projekti (Neni 3 i Marrëveshjes) si dhe rregullat për hyrjen në fuqi, ndryshimin, shfuqizimin dhe interpretimin marrëveshjes (Neni 5 i Marrëveshjes).

- *Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.*

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe me aktet ndërkombëtare.

- *Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së*
Aspektet procedurale të përafrimit

Acquis e BE-së në fushën e veprimit të projektligjit përbëhet nga legjislacioni parësor.

- Legjislacioni parësor i BE-së

Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit European (TFBE) Neni 212.

Neni 212 i TFBE parashikon bashkëpunimin ekonomik, financiar dhe teknik të BE-së me vendet që nuk janë anëtare të BE-së. Pika 3 e këtij neni përbën bazën ligjore, për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet shteteve anëtare të BE-së dhe Shteteve të Treta në këtë fushë.

Plani Kombëtar për Integrimin European 2019-2021

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjikë dhe prioritetet e parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimin European (**PKIE**) 2019-2021.

- *Konsultimi publik (nëse i është nënshtruar këtij procesi)*

Nuk ka patur konsultim publik në Komision për Integrimin European

- *Efektet financiare të aktit (nëse ka)*

Ky projektligj parashikon ratifikimin nga Kuvendi **e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018 për projektin “mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”**, ku përcaktohet se angazhimet e marra në kuadër të këtij projekti dhe, referuar shumës prej 2.000.000 eurosh, do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda katër viteve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit dhe eventualisht të financimit (Neni 1, pika 5 e Marrëveshjes). Detajet e projektit si dhe detyrimet dhe shërbimet që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, që do të lidhen ndërmjet institucioneve që janë ngarkuar ose do të ngarkohen me zbatimin e projektit (Neni 2 i Marrëveshjes).

Diskutimi në komision

Komisioni për Integrimin European vlerësoi mbështetjen e Qeverisë së Republikës Federale Gjermane në lidhje me mbështetjen e vazhdueshme në procesin e integrimit european të Republikës së Shqipërisë si dhe në veçanti mbështetjen për çeljen e negociatave.

- *Ndryshime të projektaktit (nëse ka)*

Nuk ka

- ***Rekomandime***

Nuk ka

- ***Përfundim***

- Komisioni për Integrimin Europian:
- pasi vlerësoi qëllimin e projekligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit si dhe legjislacionit në fuqi;
- pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70 dhe konstatoi se projektligji nuk ka një qëllim të tillë
- pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,

e votoi aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

KRYETARE

RUDINA HAJDARI